REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 847/20
Datë/Datum. 30.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit:* **26.10.2020**	*Data e dorëzimit të raportit:* **30.10.2020**	*Nr. i lëndës:* **847/20**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **23.10.2020**, grupi i OE: **"Triangle" Sh.p.k. & "Globi-Mi" Sh.p.k.- Suharekë,** ka parashtruar ankesë me nr.: **874/20**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës)**, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE: **"Visar Kuci" B.I. - Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Projekt me bashfinancim -Ndërtimi i shtegut të ecjes në Suharekë dhe 10 parqeve në fshatrat e Komunës së Suharekës"**, me nr. të prokurimit: **624-20-2918-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **KOMUNA SUHAREKË.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Punë**, vlera e parashikuar e kontratës: **274,174.10 €**

Shënim: Ju njoftojë se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr një (1) vendim nga OSHP **PSH nr. 592, 619/20, datë: 28.09.2020**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "Triangle" Sh.p.k. & "Globi-Mi" Sh.p.k.- Suharekë

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 56i LPP-së
Neni 59i LPP-së
Neni 60i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69i LPP-së
Neni 72i LPP-së
Vendimi i OSHP-së nr.592,613/20.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Të nderuar, ne me datë: 09.10.2020 në platformën elektronike të prokurimit kemi pranuar njoftimi mbi vendimin e AK-së, ku për kontratë ka propozuar "Visar Kuçi" B.I., ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se:*Tenderi I juaj është refuzuar nga se ju mungojnë Çertifikata përprojekte pllakat Teraco dhe hendikepve dhe të verbërve sipas kerkesës 4 dhe 5, Ju keni ofruar Çertifikata për pllako teraco për OE e jo për produktet te kerkuara për pozicionet 4.3 dhe 4.4 te pozicioneve ne paramasë, siç janë kërkuar me dosje te tenderit.*

Fillimisht ju sqarojmë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron për faktin se ne e kemi përmbushur kërkesën e lartcekur dhe jemi OE i përgjegjshëm pasi përveç kërkesës së lartcekur i kemi plotësuar edhe të gjitha kërkesat tjera të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Faktin se ne i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë e ka vërtetuar edhe vetë AK-ja në njoftimin mbi vendimin e dt.13.08.2020, ku na ka shpallur si tenderues të pasuksesshëm, sepse nëse do të ishim tenderues i papërgjegjshëm do të na eliminonte nga ky aktivitet i prokurimit edhe në njoftimin mbi vendimin e kaluar. Certifikata jonë është shumë e qartë sepse anëtari i konzorciumit tonë është prodhues dhe i certifikuar nga trupa akredituese Ëorld Quality Registrar për prodhimin e pllakave me sistem hermetik të makinerisë sipas standardit EN 13748-2, prandaj kjo certifikatë është në përputhshmëri të plotë me kërkesën e AK-së. Nëse eventualisht AK-ja ka pasur ndonjë dilemë ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së ose eventualisht ta vërtetoj vetë përmes komunikimeve me trupën akredituese.

Në FDT tekKërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **në nenin 9.1&9.2 ëhstë kërkuar si në vijim "Kërkesa4 –Operatori duhet te ketë Çertifikate nga prodhuesi per artikullin pllaka te specifikuara sipas (pozicionet 4.3) ne paramas me te cilin planifikohet te rregullohen hapësirat me aftësi te kufizuara, rampat e hendikepeve , te verbërve dhe lëvizjet e biciklave. Kërkesa 5 –Operatori duhet te ketë Certifikatë nga prodhuesi për artikullin kryesor pllaka Terreaco e specifikuar si ne pozicionin kryesor te paramases (pozicioni 4.4) me te cilin planifikohet te rregullohen hapësirat me këtë material.**

Duke u bazuar në kërkesën e lartpërmendur kuptohet qartë se certifikata jonë është konform kërkesës së FDT-së, prandaj rezulton se AK-ja na ka eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë dhe natyrisht ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së ku qartë shkruan "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

Ne realisht kemi pasur qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë edhe në herën e kaluar, ku gjatë vlerësimit AK-ja e ka shpall fitues të njëjtin operator ekonomik, mirëpo tani kemi kërkuar qasje për të shikuar dhe analizuar nëse eventualisht janë kërkuar sqarime shtesë në lidhje me dëshmitë e OE të rekomanduar për kontratë.

Ju sqarojmë se ne jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa është favorizuar OE e rekomanduar për kontratë nga ana e AK-së i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2 ku kërkesë ka qenë "*Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personelit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, që ka tri vite përvojë pune pas diplomimit. OE duhet te ketë një Ingjinjer apo master për Menaxhimin e emergjencave , se paku tri vite përvojë pune dhe te jetë i Certifikuar për menagjimin e shëndetit dhe sigurisë ne pune. OE po ashtu duhet të ketë se paku një Bachelor te Ekologjis dhe mbrojtje te mjedisit se paku 3 vjet pune pas diplomimit"*, ndërsa si dëshmi është kërkuar "- *(Diplomen kopje te Noterizuar), CV, Dëshmi qe është i e punësuar te OE ose marrëveshje te noterizuar për këtë projekt.*

Marrëveshja ne emër te projektit me ekologen **Valbone Kryeziu**, e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është valide për faktin nuk është ofruar ashtu siç është kërkuar e noterizuar dhe gjithashtu CV-ja e ekologes në fjalë është e mangët dhe nuk e dëshmon përvojën e punës ashtu siç është kërkuar sepse si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar "- *(Diplomen kopje te Noterizuar), CV, Dëshmi qe është i e*

S.B

punësuar te OE ose marrëveshje te noterizuar për këtë projekt. Pra marrëveshja nuk është e noterizuar. Gjithashtu neni 39.8 i RRUOPP e parasheh qartë kur "**CV e dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm-69**". Prandaj në këtë rast duhet aplikuar kjo dispozitë dhe ky sqarim sepse CV e ekologes nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Ne edhe në kërkesën për rishqyrtim dhe ankesën e kaluar e kemi pasur pretendim se dëshmitë e znj. Valbone Kryeziu Bachelor i Biologjisë-Ekologji dhe mbrojtje mjedisi nuk përkojnë me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa në lidhje me këtë pretendim OSHP-ja me vendimin nr.592,613/20 në faqe 27 të vendimit në paragrafin e fundit ka konstatuar citojmë "sipas kësaj CV për personin në fjalë, nuk ka prezantuar asnjë ditë përvojë pune, dhe nuk përmbush kërkesën e FDT-së si më lartë 3 vjet përvojë pune pas diplomimit. Paneli shqyrtues vlerëson se duke pasur parasysh nenin 39 të RRUOPP ku thuhet se nëse CV nuk përmbush kërkesat, si të veprohet, tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informata shtesë, pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i qëndrueshëm" mbarim citati.

Gjatë qasjes në dokumentacion pas rivlerësimit kemi vërejtur se janë kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me dëshmitë e znj. Valbone Kryeziu Bachelor i Biologjisë-Ekologji dhe mbrojtje mjedisi, e ku vërehet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një CV tjetër, e cila nuk ka ekzistuar në momentin e ofertimit, e cila CV tani përmban të dhëna në lidhje me kinse përvojën e znj. Valbone Kryeziu, ndërsa CV-ja poshtë e ka një nënshkrim V. Kryeziu, e që për neve është shumë i dyshimtë, sepse në marrëveshjen për këtë projekt nënshkrimi figuron vetëm, me iniciale V.K, ndërsa në CV V Kryeziu.

Fillimisht ofrimi i CV së re si dokument i ri i cili nuk ka ekzistuar në momentin e ofertimit është i jashtëligjshëm dhe nuk lejohet të prezantohen dokumente të cilat nuk mund të vërtetohen objektivisht se kanë ekzistuar para datës së ofertimit, këtë e parasheh edhe neni 72.3 i LPP-së ku qartë shkruan "*Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive*".
Gjithashtu me sqarime shtesë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një listë të pagave nga ATK-ja për periudhën 7/2020 e cila listë mban datën pas datës së ofertimit, pra mban dt.02.10.2020, e ku në këtë listë të pagave figuron emri i znj. Valbone Kryeziu.

Kjo listë mban datën pas datës së hapjes së ofertave, prandaj ofrimi i dokumenteve me datë pas datës së hapjes së ofertave bie në kundërshtim të plotë me nenin 72.3 të LPP-së. Përveç këtij fakti nuk mund të vërtetohet objektivisht se personat të cilat gjenden në këtë listë kanë qenë të deklaruar në ATK edhe në të kaluarën, sepse mund të paguhen kontributet dhe tatimet për personat e caktuar edhe për të kaluarën, prandaj në këtë rast nuk ka vërtetim objektiv se këta punëtorë kanë qenë të deklaruar në ATK, prandaj kjo listë e ATK-së nuk duhet të merret parasysh dhe valide sepse është në kundërshtim të plotë me nenin 72.3 të LPP-së. Po ashtu me sqarime shtesë janë ofruar edhe disa referenca që znj Valbone Kryeziu ka kryer praktiken në institucione të ndryshme kur ka qenë si studente, ndërsa janë ofruar edhe disa referenca të lëshuar nga OE i rekomanduar për kontratë kinse e njëjta ka marr pjesë në menaxhimin e disa projekteve të ndryshme 2017,2018,2019.

Është e çuditshme se në CV e dorëzuar me rastin e ofertimit nuk ka pasur fare përvojë, ndërsa tani pas sqarimeve shtesë të ketë gjithë këtë përvojë me referenca të OE të rekomanduar për kontratë.
Në lidhje me këtë çështje, AK-ja nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së nr.592,613/20 të dt.28.09.2020, sepse me vendimin e lartcekur në është lejuar që të kërkohen sqarime shtesë dhe natyrisht edhe me legjislacionin e prokurimit publik nuk lejohet të ndërmerren veprime të tilla.

S.B

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar faturën e shitblerjes në mes të Bamirs dhe Thesar për një Bager BOBCAT Tipi X331, 3.5 T-1997, mirëpo që fatura nuk është dokument valid në këtë rast dhe nuk është sipas kërkesës së FDT-së pasi që mungon Dudi apo Libreza në lidhje me pronësinë e kësaj pajisje, prandaj nuk ka dëshmi se posedon eskavator 3.5 ton siç është kërkuar.

OE i rekomanduar për kontratë me dëshmi shtesë ka ofruar dudin për këtë pajisje mirëpo ka ofruar edhe marrëveshjen për shitblerje të kësaj pajisje të lidhur ndërmjet Bamirs dhe Thesarit mirëpo që në këtë marrëveshje shkruan data e fundit e pagesës duhet të bëhet me dt.15.08.2015, kurse fatura është e dt.20.08.2018, pra në këtë rast ka mospërputhje të këtyre dëshmive me data prandaj për neve është shumë e dyshimte kjo dëshmi dhe nuk mund të merren valide këto dëshmi me këto kundërthënie të datave të shitblerjes me faturën.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka përmbushur as kërkesën nr.3 tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2, ku kërkesë ka qenë *"Kërkesa3 -Pajisjet ne Emër te OE me të cilat do të kryhen punimet. Minimumi i pajisjeve për këtë projekt është Një(1) Ekskavator, 3.5 ton, Një(1) Ekskavator , 5.5 tone, Një(1) Ekskavator 24 Tone dy(2) Kamionë të rënde, Një(1) Kamion 6 deri 6.5tone, një (1) Ngjeshës Cilindër një (1) Damper , Nje (1) Ngarkues 4.5-5 tone dhe një (1) Grejder Rrafshues"*, ndërsa si dëshmi është kërkuar *"Dëshmi mbi posedimin e pajisje, nëse paisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj (Librezat kopje ose Dokumentin Unik Duganor, faturat e blerjes). Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të pajisjeve OE duhet të ofroj Marrëveshjen (për Projekt) për shfrytëzim të pajisjeve dhe dëshminë mbi pajisjet e marrura me qera si (kopjen e librezave ose Dokumentin Unik Duganor).*

OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka prezantuar një marrëveshje me **N.T Pleqja** në të cilën nuk figuron askund se kjo marrëveshje është e nënshkruar në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, prandaj nuk mund të pranohet si e vlefshme kjo marrëveshje. Për tu konsideruar një ofertë e përgjegjshme duhet të jetë në harmoni të plotë me të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë ashtu siç e parasheh neni 59.4 i LPP-së paragrafi 4, ndërsa në këtë rast dëshmia e ofruar e OE të rekomanduar për kontratë nuk është konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, prandaj duhet eliminuar ky OE si ofertues i papërgjegjshëm. Gjithashtu në këtë rast nuk mund të kërkohet sqarime shtesë sepse tanimë ky dokument nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive ashtu siç parashihet në nenin 72.3 të LPP-së.

Ne edhe në kërkesën për rishqyrtim dhe ankesën e kaluar e kemi pasur pretendimin e tillë se në marrëveshjen në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe N.T Pleqja nuk figuron askund se kjo marrëveshje është e nënshkruar në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, e faktin se në marrëveshjen e prezantuar në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe N.T Pleqja nuk është cekur që marrëveshja është për këtë projekt, e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin nr.592,613/20, ku e ka cekur qartë se në këtë marrëveshje nuk është cekur se është e lidhur për këtë projekt mirëpo është e lidhur për "konkurrim në tenderë", ndërsa paneli shqyrtues e ka obliguar AK që gjatë rivlerësimit ta vërtetoj se a është e lidhur kjo marrëveshje për këtë projekt në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 të RRUOPP-së, mirëpo edhe pas rivlerësimit OE i rekomanduar nuk i ka ofruar sqarimet e kërkuara pasi që përsëri në marrëveshjen e prezantuar nuk figuron se kjo marrëveshje është e lidhur për këtë aktivitet të prokurimit, andaj duke u bazuar në këtë fakt OE i rekomanduar për kontratë duhet të shpallet i papërgjegjshëm, pasi që edhe pas sqarimeve shtesë nuk i ka ofruar dokumentet siç janë kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Duke pasur parasysh këto fakte rezulton se edhe pas sqarimeve shtesë OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe me rivlerësimin e AK-së nuk është respektuar vendimi i panelit shqyrtues nr.592,613/20, ku në këtë vendim është konstatuar se në marrëveshjen e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është cekur se kjo marrëveshje është e lidhur për këtë projekt mirëpo është e lidhur për "konkurrim në tenderë".

S.B

Faktin se OE i rekomanduar për kontratë dhe N.T Pleqja nuk kanë lidhur marrëveshje në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit e vërteton edhe emaili i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë email i cili i është dërguar OE të rekomanduar për kontratë nga N.T Pleqja në të cilin email askund nuk figuron qartë se OE i rekomanduar për kontratë dhe N.T Pleqja kanë marrëveshje për këtë projekt. Në sqarimin e dhënë nga OE N.T Pleqja shkruan se: "Ju konfirmojmë se marrëveshja mes dy kompanive është valide dhe ka sqaruar se OE N.T Pleqja dhe N.T.P Thesar i kanë disa marrëveshje bashkëpunimi dhe shfrytëzimi të mjeteve, mirëpo edhe pas sqarimeve të kërkuara nuk ka mundur të vërtetojë se kanë marrëveshje në lidhje me këtë projekt, siç është kërkuar në FDT dhe tek njoftimi për kontratë.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se marrëveshja për të cilën OE i rekomanduar për kontratë pretendon se është e lidhur për këtë projekt nuk qëndron pasi që askund nuk figuron emri i këtij aktiviteti të prokurimit, andaj edhe është dashur të shpallet si i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka ofruar kamionin e kërkuar me peshë 6 deri 6.5 ton por ka ofruar një kamion kiper me dy dyer me peshë prej 18 tonë me targa 04-252-HM në emër të tij dhe ka ofruar dy libreza tjera për dy kamion në emër të I Seferit me peshë 25 tonë dhe 32 tonë, prandaj këto dëshmi nuk përkojnë me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet shpallur i papërgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe tri libreza në emër të Beta Shpk me të cilin ka marrëveshje për huazimi të mjeteve por që edhe këto tri libreza dëshmojnë për kapacitet të ndryshme të këtyre kamionëve, ku dy janë nga 32 ton, ndërsa tjetri 44 ton. Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka asnjë dëshmi konkrete në lidhje me kërkesën për kamionin e kërkuar me peshë 6 deri 6.5 ton, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm në mungesë të këtyre dëshmive.

Ne edhe në kërkesën për rishqyrtim dhe ankesën e kaluar e kemi pasur pretendimin e tillë në lidhje me kamionin e kërkuar, mirëpo OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse edhe pas rivlerësimit nuk i ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas FDT-së se e posedon kamionin e kërkuar me peshën e kërkuar prej 6-6.5 ton. Prandaj duke pasur parasysh vendimin e OSHP-së i cili ka konstatuar saktë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas FDT-së në lidhje me kamionin e kërkuar me peshë prej 6-6.5ton, atëherë kuptohet qartë papërgjegjshmëria e këtij operatori ekonomik dhe kjo qështje është e gjykuar me vendimin e lartshënuar të OSHP-së dhe realisht nuk ka pasur arsye ligjore të kërkohen sqarime shtesë në lidhje me këtë qështje.

AK-ja në dosje të tenderit për asnjërën nga pajisjet e kërkuara nuk ka kërkuar kapacitetin e pajisjeve me cm3, mirëpo për të gjitha pajisjet e ka kërkuar kapacitetin në ton. Si shembull po ju sqarojmë luga ngarkuese, kamioni, eskavatori, etj., janë kërkuar me ton dhe asnjëra me kapacitet në cm3, pasi që edhe luga ngarkuese e ka një kapacitet me cm3. Andaj arsyetimi i AK-së se ka ndodhur një gabim teknik nuk qëndron dhe është i pa bazuar, pasi që AK-ja pas korrigjimit të dosjes së tenderit ka mundur ta përmirësoj, mirëpo edhe pas korrigjimit të bërë nuk e ka përmisuar kërkesën ashtu siç ka pretenduar. Andaj ky arsyetim i AK-së nuk mund të merret ndryshe përpos, devijim nga kërkesa e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Andaj duke u bazuar në këtë fakt OE i rekomanduar për kontratë edhe pas rivlerësimit nuk i ka plotësuar kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar kërkesën 4 tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë "*Operatori duhet te ketë Certifikatë nga prodhuesi për artikullin pllaka te specifikuara sipas (pozicionet 4.3) ne paramasë me te cilin planifikohet te rregullohen hapësirat me aftësi te kufizuara, rampat e hendikepeve , te verbërve*", ndërsa si dëshmi është kërkuar "*OE*

S.B

duhet ti dëshmoj marrëveshjet origjinale me prodhuesit ose kopje te noterizuar." OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se prodhuesi LOGI Group Shpk me të cilin OE i rekomanduar për kontratë ka lidhur marrëveshje në lidhje me kërkesën e lartcekur, nuk është i certifikuar nga kompanitë e licencuara për licencim të standardit EN 13748-2 ashtu siç është kërkuar, mirëpo prodhuesi në fjalë e ka bërë një certifikatë vet dhe e ka vulosur me vulë të firmës dhe e ka shënuar se produkteve i bashkangjitet edhe forma e atestit të kontrollit të cilësisë sipas EN 13748-1-2, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi se është i licencuar nga kompanitë përkatëse- kompanitë e licencuara për licencim të standardit EN 13748-2.

Gjithashtu i ka bashkangjitur disa deklarata të performancës që i ka bërë dhe nënshkruar vetë e të cilat në këtë rast nuk kanë asnjë vlerë dhe asnjë relevancë. Po ashtu janë bashkangjitur edhe test raporti për pllaka betoni 400x400x45, mirëpo edhe këto test raporte nuk mund ta dëshmojnë se prodhuesi është i certifikuar nga kompanitë e licencuara për licencim të standardit EN 13748-2, ku edhe në test raport vërehet që këto pllaka i ka dërguar vetë operatori në laborator dhe askund nuk ceket se këto pllaka janë të prodhuar me sistem hermetik të makinerisë sipas standardit EN 13748-2,

Ne edhe në kërkesën për rishqyrtim dhe ankesën e kaluar e kemi pasur pretendimin e tillë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e lartpërmendur pasi që prodhuesi LOGI Group Shpk me të cilin OE i rekomanduar për kontratë ka lidhur marrëveshje, nuk është i certifikuar nga kompani të licencuara për licencim të standardit për prodhimin e pllakave me sistem të mbyllur hermetik sipas standardit EN 13748-2 ashtu siç është kërkuar, mirëpo prodhuesi në fjalë e ka bërë një certifikatë CE dhe e ka vulosur me vulë të firmës dhe e ka shënuar se produkteve i bashkangjitet edhe forma e a testit të kontrollit të cilësisë sipas EN 13748-1-2, mirëpo edhe ai vetë nuk e ka konstatuar se e bënë prodhimin e këtyre pllakave me sistem të mbyllur, po ashtu edhe pas rivlerësimit nuk është ofruar asnjë dëshmi se është i licencuar nga kompanitë përkatëse- kompanitë e licencuara për licencim të standardit EN 13748-2. Faktin se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar dëshmitë në lidhje me kërkesën e lartcekur e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues në vendimin nr.592,613/20 ku e ka cekur se AK-ja duhet të qartësoj këtë pikë gjatë rivlerësimit në mënyrë që të saktësohet se a e ka përmbushur apo jo kërkesën e lartcekur OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo edhe pas rivlerësimit kërkesa e lartcekur nuk është përmbushur pasi që nuk janë ofruar dëshmitë se prodhuesi me të cilin ka marrëveshje OE i rekomanduar për kontratë është i licencuar nga kompanitë e licencuara për standardin EN 13748-2 për prodhimin e pllakave me sistem të mbyllur hermetik.
Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë andaj edhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe jo të rekomandohet për kontratë, pasi që me këtë veprim të AK-së po diskriminohemi ne si kompani e përgjegjshme dhe po favorizohet një kompani e cila është e papërgjegjshme.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson as kërkesën nr.6 ku kërkesë ka qenë "*Certifikata nga prodhuesi ose përfaqësuesi i Autorizuar, për lodrat e paraqitura ne skemat 1,2,3,4,5. (pozicionin 10.1 deri në 10.7)*, ndërsa si dëshmi është kërkuar "*OE duhet ti deshmoj marrveshjet origjinale me prodhuesit ose kopje te noterizuar.*". OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka prezantuar marrëveshjen në mes të prodhuesit KOÇAKPART KENT EKIPMANLARI SAN.VE TIC.LTD.STI dhe kompanisë se autorizuar NPT MOTTO COM, e cila marrëveshje nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga kompania distributore NPT MOTTO COM, prandaj nuk është valide kjo marrëveshje dhe nuk është sipas kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu edhe certifikatat e konformitetit të lodrave nga prodhuesi dhe ISO certifikatat të prezantuara në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë janë me afat te skaduar, ku shihet se një pjesë e tyre ju ka skaduar validiteti në vitin 2019 ndërsa një pjese tjetër në fillim vitin e 2020 dhe janë në gjuhën turke ku nuk mund të kuptohet përmbajtja e tyre, prandaj edhe për këtë arsye OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe është dashur të shpallet si tenderues i eliminuar.

S.B

Ne të njëjtin pretendim e kemi pasur edhe në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesën e kaluar, mirëpo edhe pse paneli shqyrtues në vendimin nr.592,613/20 e ka cekur se në lidhje me validitetin e certifikatës AK-ja duhet ta qartësojë gjatë rivlerësimit dhe të kërkojë sqarime, OE i rekomanduar për kontratë edhe pas rivlerësimit dhe sqarimeve të kërkuara nuk e ka plotësuar kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë duke mos i ofruar dëshmitë e kërkuara sipas FDT-së. Andaj ky fakt e vërteton papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë i cili është dashur të shpallet i papërgjegjshëm nga ana e AK-së dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë edhe pas sqarimeve ka prezantuar marrëveshjen në mes të prodhuesit KOÇAKPART KENT EKIPMANLARI SAN.VE TIC.LTD.STI dhe kompanisë se autorizuar NPT MOTTO COM, e cila marrëveshje përsëri nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga kompania distributore NPT MOTTO COM, prandaj nuk është valide kjo marrëveshje dhe gjithashtu nuk është konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj OE i rekomanduar për kontratë është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Marrëveshja e ofruar pas sqarimeve shtesë është një marrëveshje tjetër pra dokument i ri, ku shihet që noterizimi është bërë nga një person tjetër e që është z. Besart kuçi dhe vërehet që është futur si dëshmi shtesë edhe noterizimi për OE OK Group Shpk dhe për OE NTP Thesari, ndërsa marrëveshja e noterizuar e dorëzuar me dosje të tenderit ka qenë në emër të Egzon Kryeziu ku në këtë marrëveshje shihet edhe vula e noterit, ndërsa tek marrëveshja e prezantuar me sqarime shtesë nuk ekziston vula noterit, e që për neve është e dyshimtë kjo marrëveshje dhe kërkojmë nga ju që të detyroni AK që të bëj një verifikim të këtyre dokumenteve.

Në bazë të analizave që ne i kemi bërë certifikatave dhe Iso certifikatave për lodra kemi vërejt se janë ofruar disa certifikata dhe Iso të tjera, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta me certifikatat dhe Iso e dorëzuar me rastin e ofertimit, por që këtyre certifikatave dhe ISO iu është ndërhyrë tek data e skadimit të tyre, pra kinse janë bërë vazhdimi validitetit të këtyre certifikatave edhe për një vit. Pas verifikimit dhe analizimit në linkun e tyre me kodet të cilat i posedojnë certifikatat dhe ISO kemi vërejt se në linçet e këtyre Iso dhe certifikatat figuron statusi i dokumentit si jo valid, ndërsa Iso dhe certifikatat e ofruara me sqarime shtesë përmbajnë datë të skadimit të validitetit një vit më shumë se Iso dhe certifikatat e dorëzuar me ofertë me rastin e ofertimit, prandaj dyshojmë se ka ndërhyrje në këto dokumente pikërisht te datat e skadimit të validitetit të tyre.**Bashkangjitur keni edhe dëshmitë të cilat ne i kemi verifikuar në internet në linqet e këtyre certifikatave dhe ISO.**

Andaj duke u bazuar në të gjitha faktet e lartpërmendura OE i rekomanduar është dashur të shpallet i papërgjegjshëm dhe të eliminohet nga konkurrenca.

Ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e OE **"Vehbi Mamaj" B.I** dhe **"€ EURO-GROUP " SH. P.K**, pasi që të dy këta OE janë të papërgjegjshëm.

Ne me dt. 20.10.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.
Në lidhje me arsyetimin e AK-së ku e ka cekur se pretendimi ynë në lidhje me CV për ekologen Valbona Kryeziu nuk qëndron dhe ku ju ka referuar nenit 39 të RRUOPP-së "CV-ja e kërkuar nuk përmban informatat e kërkuara-AK-ja nuk mund të vendos mund të kërkohen informata shtesë, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-sëështë absolutisht i pa bazuar pasi që AK-ja me këtë veprim e ka treguar haptas favorizimin për OE të rekomanduar për kontratë, pasi që ju ka referuar nenit të cilit ju ka përshtatur OE tërekomanduar për kontratë, mirëpo ne e kemi sqaruar shumë qartë se dëshmitë e znj. Valbone Kryeziu Bachelor i Biologjisë-Ekologji dhe mbrojtje mjedisi nuk përkojnë me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa në lidhje me këtë

S.B

pretendim OSHP-ja me vendimin nr.592,613/20 në faqe 27 të vendimit në paragrafin e fundit ka konstatuar citojmë "sipas kësaj CV për personin në fjalë, nuk ka prezantuar asnjë ditë përvojë pune, dhe nuk përmbush kërkesën e FDT-së si më lartë 3 vjet përvojë pune pas diplomimit. Paneli shqyrtues vlerëson se duke pasur parasysh nenin 39 të RRUOPP ku thuhet se nëse CV nuk përmbush kërkesat, si të veprohet, tenderi duhet të refuzohet pa kërkuar informata shtesë, pretendimi i palës në ankesë në këtë pikë është i qëndrueshëm" mbarim citati. Pra fakti i lartcekur tregon qartë se AK-ja nuk është dashur të kërkoj informata shtesë por është dashur të refuzoj tenderin.
Mirëpo edhe pas sqarimeve shtesë nga ana e AK-së në lidhje me ekologen e lartpërmendur OE i rekomanduar për kontratë përsëri nuk i plotëson kërkesat e FDT-së dhe tënjoftimit për kontratë pasi qëOE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një CV tjetër, e cila nuk ka ekzistuar në momentin e ofertimit, e cila CV tani përmban të dhëna në lidhje me kinse përvojën e znj. Valbone Kryeziu, ndërsa CV-ja poshtë e ka një nënshkrim V. Kryeziu, e që për neve është shumë i dyshimtë, sepse në marrëveshjen për këtë projekt nënshkrimi figuron vetëm, me iniciale V.K, ndërsa në CV V Kryeziu. E faktin se nuk lejohet të prezantohen dokumente të cilat nuk mund të vërtetohen objektivisht se a kanë ekzistuar para datës së ofertimit, e parasheh edhe neni 72.3 i LPP-së. Gjithashtu arsyetimi i AK-së nuk qëndron për faktin se me sqarime shtesë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një listë të pagave nga ATK-ja për periudhën 7/2020 e cila listë mban datën pas datës së ofertimit, pra mban dt.02.10.2020, e ku në këtë listë të pagave figuron emri i znj. Valbone Kryeziu.
Kjo listë mban datën pas datës së hapjes së ofertave, prandaj ofrimi i dokumenteve me datë pas datës së hapjes së ofertave bie në kundërshtim të plotë me nenin 72.3 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura dhe në vendimin e OSHP-së nr.592,613/20 të dt.28.09.2020, rezulton se ky pretendim është çështje e gjykuar sipas nenit 105 paragrafi 1.16, në të cilin paragrafi parashihet qartë se *"Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".*

shihet qartë se arsyetimi i AK-së në lidhje me pretendimin tonë të lartcekur është i pa bazuar dhe nuk qëndron.

Gjithashtu AK-ja në vendimin për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim në lidhje me pretendimet tona për pajisjet e kërkuara i ka cilësuar si të pa qëndrueshme, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat në lidhje me pajisjet e kërkuara, mirëpo vetëm e ka cekur se OE i rekomanduar për kontratë i posedon të gjitha paisjet e nevojshme të kërkuara, gjithashtu e ka cekur se ka pranuar email nga OE me të cilët kinse ka marrëveshje për paisje, ku e mbështesin OE të rekomanduar për kontratë me paisjet e kërkuara. Vetë AK-ja me këtë arsyetim e ka vërtetuar se nuk ekzistojnë marrëveshjet për të cila ne kemi pasur pretendime, pasi që nëse do të ekzistonin marrëveshjet ne lidhje për këtë projekt atëherë OE do të deklaronin qartë se marrëveshjet janë të lidhura për këtë projekt. Andaj pasi që AK-ja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi në lidhje me pretendimet tona ankimore, por vetëm e ka cekur se janë përmbushur kërkesat nga ana e OE të rekomanduar për kontratë me këtë fakt vërtetohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe tënjoftimit për kontratë, pasi që nëse do ti plotësonte AK-ja do të na sqaronte me dëshmi të cilat tregojnë se OE i rekomanduar për kontratë i përmbush kërkesat, mirëpo që një veprim i tillë nuk është bërë nga ana e AK-së.

Gjithashtu në lidhje me arsyetimin e AK-së se certifikatat për lodra të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë edhe pas rivlerësimit dhe sqarimeve të kërkuara janë valid, ju sqarojmë se ky pretendim nuk qëndron për faktin se AK-ja nuk ka dhënë asnjë dëshmi në lidhje me këto certifikata për lodra, pasi që është dashur të ofrohen dëshmi se si e plotëson kërkesën në lidhje me certifikatat për lodra OE i rekomanduar për kontratë pasi që ne shumë qartë e kemi shpjeguar se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas FDT-së sepse në marrëveshjen e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë në mes të prodhuesit KOÇAKPART KENT EKIPMANLARI SAN.VE TIC.LTD.STI dhe kompanisë se autorizuar NPT MOTTO COM, nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga kompania distributore NPT MOTTO COM, ndërsa

S.B

edhe pas sqarimeve të kërkuar është ofruar certifikata pa nënshkrim dhe e pa vulosur, mirëpo është ofruar një marrëveshje tjetër pra dokument i ri, ku shihet që noterizimi është bërë nga një person tjetër e që është z. Besart kuçi dhe vërehet që është futur si dëshmi shtesë edhe noterizimi për OE OK Group Shpk dhe për OE NTP Thesari, ndërsa marrëveshja e noterizuar e dorëzuar me dosje të tenderit ka qenë në emër të Egzon Kryeziu ku në këtë marrëveshje shihet edhe vula e noterit, ndërsa tek marrëveshja e prezantuar me sqarime shtesë nuk ekziston vula noterit, e që për neve është e dyshimtë kjo marrëveshje dhe kërkojmë nga ju që të detyroni AK që të bëj një verifikim të këtyre dokumenteve. Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekur shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu faktin se OE i rekomanduar për kontratë e ka vërtetuar vetë autoriteti kontraktues pasi që në vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nuk e ka shqyrtuar fare pretendimin tonë ankimor në lidhje me Certifikatën e kërkuar nga prodhuesi për artikullin pllaka te specifikuara, ndërsa me këtë veprim e ka vërtetuar edhe më shumë faktin se OE i rekomanduar për kontratëështë i papërgjegjshëm sepse nëse OE i rekomanduar për kontratë do ta plotësonte këtë kërkesë atëherë AK-ja do ta sqaronte me dëshmi duke e vërtetuar se është përmbushur kërkesa, mirëpo që një vërtetim i tillë nuk është bërë, andaj OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe tënjoftimit për kontratë.

Sa i përket pretendimit tonë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe tënjoftimit për kontratë, të cilin pretendim AK-ja e ka cilësuar si të pa bazuar, ju sqarojmë se arsyetimi i AK-së nuk qëndron për faktin se ne e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit, sepse e certifikata e prezantuar nga ana jonë është shumë e qartë sepse anëtari i konzorciumit tonë është prodhues dhe i certifikuar nga trupa akredituese World Quality Registrar për prodhimin e pllakave me sistem hermetik të makinerisë sipas standardit EN 13748-2, prandaj kjo certifikatë është në përputhshmëri të plotë me kërkesën e AK-së, mirëpo AK-ja po mundohet të na eliminojë nga ky aktivitet i prokurimit duke na diskriminuar neve edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht po e favorizon haptas OE të rekomanduar për kontratë, duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Edhe pas ankese për rivlerësim AK nuk ka kërkuar sqarime shtese, mirëpo ka dhënë përgjigje për eliminimin tone se si duhet te paiset një prodhues me certifikate. Te gjitha këto pika qe i ka cek AK, ne i posedojmë dhe anëtari tjetër i konsorciumit ka kaluar neper këto pika për tu pajisur me këtë Certifikatë.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se arsyetimi i AK-së për refuzimine kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe nuk qëndron.

Autoriteti kontraktues e ka favorizuar hapur OE e rekomanduar për kontratë, sepse për të njëjtat mungesa i ka eliminuar operatorët ekonomik tjerë që janë me çmim më të lirë, madje edhe me çmim më të lartë, ndërsa OE e rekomanduar për kontratë e ka cilësuar të përgjegjshëm, siç është rasti për mungesë të certifikatave të pllakave nga prodhuesi, certifikatat nga prodhuesi për lodrat paraqitura në skemat 1,2,3,4,5, marrëveshjet për shfrytëzim të pajisjeve, etj.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët** sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Autoriteti kontraktues nenin 72 të LPP-së nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë por e ka shfrytëzuar për të favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë sepse ka kërkuar sqarime për dëshmi të cilat neni 72 i LPP-së nuk e lejon dhe për dëshmi të cilat kanë qenë të qarta dhe të konfirmuara që nuk janë në përputhje me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

S.B

OE i rekomanduar për kontratë nuk ka mundur ti ofrojë dëshmitë e kërkesave sipas nenit 64 të LPP-së, ndërsa autoriteti kontraktues nuk ka vepruar sipas nenit 67 paragrafi 2 të LPP-së për ta eliminuar këtë OE sepse nuk ka ofruar prova të mjaftueshme, sipasnenit69tëkëtijligji për të dëshmuar se është i përgjegjshëm.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktuesdo titrajtojoperatorëtekonomiknë mënyrëtëbarabartëdhejo-diskriminuese dhedo tëveprojë nëmënyrë transparente.*Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që(vi) qëtenderiizgjedhur tëpërputhetme të gjithaaspektet përmbajtjesore tëkushteve,kriterevedhespecifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike,burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dheburimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, ankesa e OE**"TRIANGLE" SH.P.K** si e bazuar
ANULOHET,njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK) – Ankesa në OSHP, janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në AK. Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet në - Ankesën në OSHP –janë të njëjta deklaratën me atë te dorëzuar ne kërkesa për rishqyrtim pran AK-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kapaciteti teknik dhe profesional:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare***
Kërkesa 1- Operatori Ekonomik duhet te ofroje dëshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate ne vlerën prej se paku 400,000.00 Euro, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve. **Kërkesa 2** –Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personelit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushenperkatese, se paku një	**Evidencat:** **Dëshmia -1** - Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara ne tre vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbaliet e pranimit teknik. **Dëshmia -2** - (Diplomen kopje te Noterizuar), CV, Deshmi qe eshte i e punsuar te OE ose marrveshje te noterizuarperkëte projekt .

S.B

Inxhinier i dipomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose master i ndertimtarise drejtimi konstruktiv, që ka tri vite përvojë pune pas diplomimit. OE duhet te ketnjeIngjinjer apo masterper Menaxhimin e emerxhencave , se paku tri vite përvojë pune dhe te jet i Certifikuar permenagjimin e shendetit dhe siguris ne pune. OE po ashtu duhet të ketë se paku njeBachelor te Ekologjis dhe mbrojtje te mjedisit se paku 3 vjet pune pas diplomimit. **Kërkesa3** -Pajisjet ne Emër te OE me të cilat do të kryhen punimet. Minimumi i pajisjeve për këtë projekt është Një(1) Ekskavator, 3.5 ton, Një(1) Ekskavator , 5.5 tone, Një(1) Ekskavator 24 Tone dy(2) Kamionë të rënde,Një(1) Kamion 6 deri 6.5tone, një (1) Ngjeshës Cilindër nje (1) Damper , Nje (1) Ngarkues 4.5-5 tone dhe një (1) Grejder Rrafshues. **Kërkesa4** –Operatori duhet te ketë Çertifikate nga prodhuesi per artikullin pllaka te specifikuara sipas (pozicionet 4.3) ne paramas me te cilin planifikohet te rregullohen hapsirat me aftesi te kufizuara, rampat e hendikepeve , te verberve dhe levizjet e biciklave. **Kërkesa 5** –Operatori duhet te ketë Çertifikate nga prodhuesi per artikullin kryesor pllaka Terreaco e e specifikuar si ne pozicionin kryesor te paramases (pozicioni 4.4) me te cilin planifikohet te rregullohen hapsirat me kete material. **Kerkesa 6** –Certifikata nga prodhuesi ose perfaqesuesi i Autorizuar, per lodrat e paraqitura ne skemat 1,2,3,4,5. (pozicionin 10.1 deri në 10.7) .	**Dëshmia 3-** Dëshmi mbi posedimin e paisje, nëse paisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj (Librezat kopje ose Dokumentin Unik Duganor, faturat e blerjes). Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të paisjeve OE duhet të ofroj Marrveshjen (për Projekt) për shfrytëzimm të paisjeve dhe dëshmin mbi paisjet e marrura me qera si (kopjen e librezave ose Dokumentin Unik Duganor) **Dëshmia 4, 5, 6 -** OE duhet ti dëshmoj marrveshjet origjinale me prodhuesit ose kopje te noterizuar.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:(Tëpërshkruhetvetëmvlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni pasi Rivlerësoi ofertat konkurruese i rekomandon ZP që të shpall fitues OE Visar Kuçi B.I me çmim më të lire ne vlerë prej 234.324,10 Euro.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)
///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).
///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).
///

S.B

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Triangle" Sh.p.k. & "Globi-Mi" Sh.p.k.- Suharekë

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron për faktin se ne i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë e ka vërtetuar edhe vetë AK-ja në njoftimin mbi vendimin e datës 13.08.2020, ku na ka shpallur si tenderues të pasuksesshëm, sepse nëse do të ishim tenderues i papërgjegjshëm do të na eliminonte nga ky aktivitet i prokurimit edhe në njoftimin mbi vendimin e kaluar. Certifikata jonë është shumë e qartë sepse anëtari i konzorciumit tonë është prodhues dhe i certifikuar nga trupa akredituese World Quality Registrar për prodhimin e pllakave me sistem hermetik të makinerisë sipas standardit EN 13748-2, prandaj kjo certifikatë është në përputhshmëri të plotë me kërkesën e AK-së. Nëse eventualisht AK-ja ka pasur ndonjë dilemë ka mundur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së ose eventualisht ta vërtetoj vetë përmes komunikimeve me trupën akredituese.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK ne vlerësimin e pare ne këtë aktivitet te prokurimit OE ankues e ka shpallur si tenderues te pasuksesshëm duke e nxjerr te përgjegjshëm, kurse tani ne raportin e rivlerësimit te datës 09.10.2020 komisioni i vlerësimit e shpalle te papërgjegjshëm duke mos dhënë asnjë arsyetim, duke shkelur nenin 40.11 te RRUOPP-se, po citoj: "*Komisioni, në fund të detyrës së tij, do të dërgoj te Zyrtari përgjegjës te Prokurimit një rekomandim së bashku me një raport mbi punën e komisionit dhe një deklaratë të arsyeve mbështetëse për këtë rekomandim, duke përfshirë një deklaratë në lidhje me përparësitë dhe dobësitë e secilit propozim të tenderuesve*". Gjithashtu, AK – Komisioni i vlerësimit nuk ka respektuar **nenin 7 paragrafi 1 të LPP-së**, po citoj: "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*", sepse OE ankues anëtari i konsorcuimit ka prezantuar Certifikata, ***World Quality Registrar*** për prodhimin e pllakave me sistem hermetik të makinerisë sipas standardit EN 13748-2, dhe plotëson kërkesën e FTD-së te përcaktuar nga autoriteti kontraktues, mirëpo AK-Komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar fare sqarim, lidhur me dyshimet qe ka mundur ti ketë me dëshmitë e ofruar nga OE ankues ne këtë aktivitet te prokurimit, andaj AK – komisioni i vlerësimit, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së**. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2 ku kërkesë ka qenë "*Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik, në veçanti të personelit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për realizimin e projektit. Stafi i kualifikuar ne fushën përkatëse, se paku një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose master i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, që ka tri vite përvojë pune pas diplomimit. OE duhet te ketë një Ingjinjer apo master për Menaxhimin e emergjencave , se paku tri vite përvojë pune dhe te jetë i Certifikuar për menagjimin e shëndetit dhe sigurisë ne pune. OE po ashtu duhet të ketë se paku një Bachelor te Ekologjis dhe mbrojtje te mjedisit se paku 3 vjet pune pas diplomimit*", ndërsa si dëshmi është kërkuar "- *(Diplomën kopje te Noterizuar), CV, Dëshmi qe është i e punësuar te OE ose marrëveshje te noterizuar për këtë projekt.* Marrëveshja ne emër te projektit me ekologen **Valbone Kryeziu**, e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është valide për faktin nuk është ofruar ashtu siç është kërkuar e noterizuar dhe gjithashtu CV-ja e ekologes në fjalë është e mangët dhe nuk e dëshmon përvojën e punës ashtu siç është kërkuar sepse si dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar "- *(Diplomën kopje te Noterizuar), CV, Dëshmi qe është i e punësuar te OE ose marrëveshje te noterizuar për këtë projekt.* Pra marrëveshja nuk është e noterizuar.
Gjithashtu neni 39.8 i RRUOPP e parasheh qartë kur "**CV e dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm-69**". Prandaj në këtë rast duhet aplikuar kjo dispozitë dhe ky sqarim sepse CV e ekologes nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

S.B

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale te FDT-se, po citoj: **Kërkesa 2**: *OE po ashtu duhet të ketë se paku një Bachelor te Ekologjisë dhe mbrojtje te mjedisit se paku 3 vjet pune pas diplomimit.*. **Dëshmia 2:-** *(Diplomën kopje te Noterizuar), CV, Dëshmi qe është i e punësuar te OE ose marrëveshje te noterizuar për këtë projekt.* OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ne platformën elektronike e-prokurim ne ofertën e tij ka ngarkuar Diplomën e noterizuar te noteri me date 13.11.2019 për znj. Valbona Kryeziu – Bachelor i Biologjisë – Ekologji dhe Mbrojtje Mjedisi, lëshuar me date 23.04.2014 me nr. 1406, ndërsa marrëveshja bashkëpunimi nuk është e noterizuar tek noteri, kurse ne CV e prezantuar përvoja e punese mungon d.m.th. sipas kësaj CV për personi ne fjale, nuk ka prezantuar asnjë ditë përvojë pune, dhe nuk përmbush kërkesën e FDT-së si me lartë 3 vjet pune pas diplomimit, prandaj bazuar ne nenin 39 te RrUOPP-se varësisht nga rasti i paraqitur:

Problemi	Si teveprohet?	Nenii LPP-se
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtutjeshëm	Neni 69

Duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne platformën elektronike e-prokurim, **eksperti shqyrtues sqaron** se AK – ZPP, me date 02.10.2020 përmes platformës elektronike ka kërkuar sqarim nga OE i rekomanduar për kontrate lidhur me CV, ne kundërshtim me **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe **nenin 39 te RrUOPP-së,** ndërsa lidhur me marrëveshjen e cila nuk është e noterizuar, nuk ka kërkuar fare sqarim, prandaj me këto veprime AK ka vepruar ne kundërshtim me **nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik*", si dhe **neni 59 par. 4 të LPP-së**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*, gjithashtu AK – ZPP, nuk e ka respektuar **vendimin e PSH. nr. 592,613/20 të dt.28.09.2020**. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar faturën e shitblerjes në mes të Bamirs dhe Thesar për një Bager BOBCAT Tipi X331, 3.5 T-1997, mirëpo që fatura nuk është dokument valid në këtë rast dhe nuk është sipas kërkesës së FDT-së pasi që mungon Dudi apo Libreza në lidhje me pronësinë e kësaj pajisje, prandaj nuk ka dëshmi se posedon eskavator 3.5 ton siç është kërkuar.

OE i rekomanduar për kontratë me dëshmi shtesë ka ofruar dudin për këtë pajisje mirëpo ka ofruar edhe marrëveshjen për shitblerje të kësaj pajisje të lidhur ndërmjet Bamirs dhe Thesarit mirëpo që në këtë marrëveshje shkruan data e fundit e pagesës duhet të bëhet me dt.15.08.2015, kurse fatura është e dt.20.08.2018, pra në këtë rast ka mospërputhje të këtyre dëshmive me data prandaj për neve është shumë e dyshimte kjo dëshmi dhe nuk mund të merren valide këto dëshmi me këto kundërthënie të datave të shitblerjes me faturën.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale te FDT-se, **Kërkesa në FDT është:**

Kërkesa3 -Pajisjet ne Emër te OE me të cilat do të kryhen punimet. Minimumi i pajisjeve për këtë projekt është Një(1) Ekskavator, 3.5 ton, Një(1) Ekskavator , 5.5 tone, Një(1) Ekskavator 24 Tone dy(2) Kamionë të rënde, Një(1) Kamion 6 deri 6.5tone, një (1) Ngjeshës Cilindër një (1) Damper , Një (1) Ngarkues 4.5-5 tone dhe një (1) Grejder Rrafshues.	Dëshmia 3- Dëshmi mbi posedimin e pajisje, nëse pajisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj *(Librezat kopje ose Dokumentin Unik Duganor, faturat e blerjes).* Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të pajisjeve OE duhet të ofroj Marrëveshjen (për Projekt) për shfrytëzimm të pajisjeve dhe dëshminë mbi pajisjet e marrura me qera si (kopjen e librezave ose Dokumentin Unik Duganor)

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës pas lastrës standarde te sqarimit nga AK me datës 02.10.2020 dhe përgjigjes me date 05.10.2020 ka prezantuar **faturën me nr. 35/2018** te datës 20.12.2018 ne mes te OE:**NTP 'Bamire" (Sinan Bajraktari)** si *shitës* dhe OE: **NTP "Thesar" (Visar Kuqi B.I.)** si *blerës* te datës 10.04.2020, se bashku me Dud

S.B

Doganor, mirëpo ekziston një diferencë e madhe kohe ne mes faturës dhe marrëveshjes, mirëpo OE i rekomanduar për dhënie te kontratës sqaron se janë te lajmëruar ne librin e blerjeve te muajit 12 viti 2018 dhe te deklaruara ne ATK, dhe kjo është e pranishëm për AK dhe konsideroj se plotëson kërkesën e FDT-se, si me lart. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka përmbushur kërkesat nr. 3 tek kapaciteti teknik dhe profesionale neni 9.1 & 9.2 te FDT-se, pasi ka prezantuar një marrëveshje me **N.T. Pleqja** ne te cilën nuk figuron askund se kjo marrëveshje është nënshkruar ne lidhje me këtë aktivitet te prokurimit – Marrëveshje për këtë projekt, prandaj nuk mund te pranohet si e vlefshme kjo marrëveshje.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues ka prezantuar një marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve, prezantuar nga OE i rekomanduar për kontrate, ne mes palëve OE: **NT "Pleqja"** – *qiradhënës* dhe OE: **NTP "Thesar" Shpk, (Visra Kuci B.I.)** *qiramarrës*, e datës 78.07.2017, ne te cilën marrëveshje nuk shkruan askund se është për këtë projekt – aktivitet te prokurimit, ndërsa pas sqarimeve te kërkuar nga AK te datës 02.10.2020, OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar një konfirmim te nënshkruar dhe vulosur nga NT "PLEQJA" ku thotë: "*Ne i kemi disa marrëveshje bashkëpunimi dhe shfrytëzimi ne mes NT PLEQJA dhe NTP THESAR dhe anasjelltas, Ne këtë marrëveshje është i përfshirë mjeti marka LIBHERR. Tipi : A904 Litronic, pjesa përcjellëse 1 lug bageri e përdorur, pesha neto ne kg: 19000.00*", as ne këtë konfirmim nuk thuhet, precizohet se kjo pajisje është e destinuar për këtë aktivitet te prokurimit, ashtu siç kërkohet ne FDT, tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale **neni 9.1 & 9.2 te FDT-se**, *Dëshmia 3- Dëshmi mbi posedimin e pajisje, nëse pajisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj (Librezat kopje ose Dokumentin Unik Duganor, faturat e blerjes). Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të pajisjeve OE duhet të ofroj Marrveshjen (për Projekt) për shfrytëzimm të paisjeve dhe dëshmin mbi pajisjet e marruar me qira si (kopjen e librezave ose Dokumentin Unik Duganor)*, prandaj AK nuk ka respektuar **neni 59 par. 4 të LPP-së**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka ofruar kamionin e kërkuar me peshë 6 deri 6.5 ton por ka ofruar një kamion kiper me dy dyer me peshë prej 18 tonë me targa 04-252-HM në emër të tij dhe ka ofruar dy libreza tjera për dy kamion në emër të I Seferit me peshë 25 tonë dhe 32 tonë, prandaj këto dëshmi nuk përkojnë me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet shpallur i papërgjegjshëm OE i rekomanduar për kontratë. OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe tri libreza në emër të Beta Shpk me të cilin ka marrëveshje për huazimi të mjeteve por që edhe këto tri libreza dëshmojnë për kapacitet të ndryshme të këtyre kamionëve, ku dy janë nga 32 ton, ndërsa tjetri 44 ton. Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka asnjë dëshmi konkrete në lidhje me kërkesën për kamionin e kërkuar me peshë 6 deri 6.5 ton, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm në mungesë të këtyre dëshmive.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale te FDT-se, **Kërkesa në FDT është:**

Kërkesa3 -Pajisjet ne Emër te OE me të cilat do të kryhen punimet. Minimumi i pajisjeve për këtë projekt është Një(1) Kamion 6 deri 6.5 tone,	Dëshmia 3- Dëshmi mbi posedimin e pajisje, nëse pajisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj *(Librezat kopje ose Dokumentin Unik Duganor, faturat e blerjes)*. Nëse OE ka Marrëveshjet për Shfrytëzim të pajisjeve OE duhet të ofroj Marrëveshjen (për Projekt) për shfrytëzim të pajisjeve dhe dëshminë mbi pajisjet e marruar me qira si (kopjen e librezave ose Dokumentin Unik Duganor)

S.B

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar ne dokumentet e tenderit te tij kamionin ne emër te kompanisë "Visar Kuci" B.I., prodhuesi: Mercedes-Benz, Tipi: 952.50, pesha maksimale e lejuar e peshës: 8.5 ton, qe do te thotë se nuk është brenda kërkese te kërkuar nga AK ne FDT, sepse këtu AK ka caktuar peshën minimale dhe peshën maksimali, gjithashtu ka prezantuar një marrëveshje për shfrytëzim te mjeteve me OE: "I Seferin" Shpk, ku janë dy libreza te kampioneve me peshe 12.9 dhe 18.4 ton, qe do te thotë nuk e plotëson kërkesën e FDT-se si me lart, andaj AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar **nenin 7 të LPP-së**, po citoj: "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*", si dhe **nenin 59.4 të LPP-së**, po citoj: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*". Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 6

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se prodhuesi LOGI Group Shpk me të cilin OE i rekomanduar për kontratë ka lidhur marrëveshje në lidhje me kërkesën e lartcekur, nuk është i certifikuar nga kompanitë e licencuara për licencim të standardit EN 13748-2 ashtu siç është kërkuar, mirëpo prodhuesi në fjalë e ka bërë një certifikatë vet dhe e ka vulosur me vulë të firmës dhe e ka shënuar se produkteve i bashkëngjitet edhe forma e atestit të kontrollit të cilësisë sipas EN 13748-1-2, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi se është i licencuar nga kompanitë përkatëse kompanitë e licencuara për licencim të standardit EN 13748-2. Gjithashtu i ka bashkangjitur disa deklarata të performancës që i ka bërë dhe nënshkruar vetë e të cilat në këtë rast nuk kanë asnjë vlerë dhe asnjë relevancë. Po ashtu janë bashkangjitur edhe test raporti për pllaka betoni 400x400x45, mirëpo edhe këto test raporte nuk mund ta dëshmojnë se prodhuesi është i certifikuar nga kompanitë e licencuara për licencim të standardit EN 13748-2, ku edhe në test raport vërehet që këto pllaka i ka dërguar vetë operatori në laborator dhe askund nuk ceket se këto pllaka janë të prodhuar me sistem hermetik të makinerisë sipas standardit EN 13748-2,

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale te FDT-se, **Kërkesa në FDT është:**

Kërkesa4 –Operatori duhet te ketë Çertifikate nga prodhuesi per artikullin pllaka te specifikuara sipas (pozicionet 4.3) ne paramas me te cilin planifikohet te rregullohen hapsirat me aftesi te kufizuara, rampat e hendikepeve , te verberve dhe levizjet e biciklave. Kërkesa 5 –Operatori duhet te ketë Çertifikate nga prodhuesi per artikullin kryesor pllaka Terreaco e e specifikuar si ne pozicionin kryesor te paramases (pozicioni 4.4) me te cilin planifikohet te rregullohen hapsirat me kete material.	Dëshmia 4, 5, 6 - OE duhet ti dëshmoj marrveshjet origjinale me prodhuesit ose kopje te noterizuar.

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar ne tenderin e tij një marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin **LOGI GROUP SHPK – Lubizhd – Prizren,** me date 08.07.2020 te noterizuar tek noteri, duke ja bashkangjitur dhe Certifikatën e Prodhuesit lidhur me Pllakat Terase si dhe Test raport nga Laboratori i akredituar **NSH "IBMS"**– Prishtine, te datës 29.04.2020, materiali i testuar – Pllaka betoni 400x400x45 mm, ne te cilin raport thuhet se mostrat janë sjelle nga prodhuesi "Logo Group" Shpk, janë testuar sipas standardit EN 13748-2, mirëpo pozicioni 4.3 dhe 4.4 ne paramas dhe parallogarit ku thotë: *"Furnizimi dhe montimi I pllakave terraco një shtresore e mermert me granulat kuarci, diabazi, bazalti etj.. format 40x40x4.5 cm te prodhuara me sistem hermetik te makinerise. E testuar sipas EN 13748-2 E rezervuar dhe imregnuarper rezistence nga UV me efekt easyclean, ngjyra te percaktohet nga organin mbikqyres*", kurse çertifikata e prodhuesit është e nënshkruar dhe vulosur nga vet prodhuesi dhe nuk është e certifikuar nga ndonjë trup certifikues për standardin EN 13748-2, andaj AK- ZPP – komisioni i vlerësimit, **nuk kane zbatuar vendimin e PSH. nr. 59, 613/20 te datës 08.09.2020**, sepse ne raportin e vlerësimit te datës 09.10.2020 nuk është sqaruar fare se OE i rekomanduar për kontrate e plotëson këtë kërkesë te FDT-se (e cila edhe ashtu është me shumë kuptime edhe nga ata qe vet e kane vendos, nuk e din çka kanë kërkuar dhe me çka duhet te dëshmohet), ndërsa ZPP ne vendimin mbi refuzim e kërkesës për rishqyrtim te OE ankues te datës 21.10.2020, tek arsyetimi jap këtë sqarim, po citoj: "*Qe një produkt te jete i certifikuar, duhet qe prodhuesi ti ndjektë këta hapa sipas standardit rregulloreve dhe ligjit te ndërtimit, si ne vijim:*

S.B

1/ Për pllako teraco standardi përkatës EN 13748-1-2
2/ Prodhuesi duhet te jete i certifikuar me sistemin për menaxhimin e kontrollit te cilësie ISO 9000 2015
3/ Te ketë marrveshje me laborator te jashtëm te akredituar për standardin EN 13748-2 për kontrollin e fabrikës dhe prodhimit shih LIGJIN Nr. 6/L-033"

Duke u bazuar ne këto fakte dhe dëshmi te prezantuar ne platformën elektronike lidhur me këtë aktivitet te prokurimit **eksperti shqyrtues sqaron** se ZPP, nuk ka arrit te vërtetoj dhe te sigurohet se OE i rekomanduar për kontrate ka arri te plotësoj kërkesën e FDT-se, prandaj AK – komisioni i vlerësimit ka mundur te të kërkoj sqarime shtesë bazuar në **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së** dhe te sigurohet se kjo certifikate plotëson kërkesën e FDT-së. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 7

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson as kërkesën nr.6 ku kërkesë ka qenë *"Certifikata nga prodhuesi ose përfaqësuesi i Autorizuar, për lodrat e paraqitura ne skemat 1,2,3,4,5. (pozicionin 10.1 deri në 10.7)*, ndërsa si dëshmi është kërkuar *"OE duhet ti dëshmoj marrëveshjet origjinale me prodhuesit ose kopje te noterizuar."*. OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka prezantuar marrëveshjen në mes të prodhuesit KOÇAKPART KENT EKIPMANLARI SAN.VE TIC.LTD.STI dhe kompanisë se autorizuar NPT MOTTO COM, e cila marrëveshje nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga kompania distributore NPT MOTTO COM, prandaj nuk është valide kjo marrëveshje dhe nuk është sipas kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale te FDT-se, **Kërkesa në FDT është:**

Kërkesa 6 –Certifikata nga prodhuesi ose përfaqësuesi i Autorizuar, per lodrat e paraqitura ne skemat 1,2,3,4,5. (pozicionin 10.1 deri në 10.7) .biciklave.	Dëshmia 4, 5, 6 - OE duhet ti dëshmoj marrëveshjet origjinale me prodhuesit ose kopje te noterizuar.

OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ka prezantuar një marrëveshje bashkëpunim me palëve OE: **NTP THESAR (Visar Kuci B.I)** dhe OE: **N.P.T. " MOTTO COM"** te nënshkruar dhe vulosur nga te dy palët e marrëveshjes dhe e cila është e noterizuar nga noteri, gjithashtu është prezantuar **Distributor Letter** te datës 17.06.2019 nga prodhuesi Kocak Park ne Turqi, ku thuhet se Distributor për Kosovës është OE: **N.P.T. " MOTTO COM"** – Fushe Kosove, duke bashkangjitur disa dokument si: Certifikata nga TSE – Turkish Standar Institucion (Certificateof Conformity to Turkish Standar); ISO standarde, te cilat janë me afat te skadimit te validitet, para publimit te njoftimit për kontratë te këtij aktiviteti te prokurimit, ndërsa pas kërkesë për sqarim nga AK te datës 02.10.2020 Letrës standarde te sqarimit, lidhur me këto certifikata, OE i rekomanduar per kontrate me date 05.10.2020 ka prezantuar certifikata me afat te vlefshmërisë për vitin 2020, qe do te thotë se plotëson kërkesën e FDT-se, si me larte, Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 8

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 1, 6, 7, 59, 60 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit nuk ka respektuar **nenin 1, 6, 7, 59, 60, 64 të LPP-së**, andaj **Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP,** që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, sepscifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit dhe te respektohen kriteret e dhënies.

S.B

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, **të aprovohet si e bazuar**, dhe rekomandon të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK (rekomandimi për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues –Komuna Suharekë*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *Grupi i OE ankues – "Triangle" Sh.p.k. & "Globi-Mi" Sh.p.k.- Suharekë*

S.B